




Funded by
the European Union

RAPORT ANALITIK

Pabarazitë në arsim



EduPod 2



KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Projekti *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - shkurt **IDEA 2022**, financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit, projekti synon të identifikojë problematikat e fushës së arsimit në Kosovë duke zgjeruar hapësirat për debat publik me anë të shfrytëzimit të teknologjive inovative siç janë podkastet. Në këto diskutime janë të përfshira palë kyçe në sistemin arsimor, si nxënës/e, mësues/mësues/e, prindër, politikëbërës etj. ku u jepet mundësia për të ballafaquar mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Seria e podkasteve **EduPod** (shkurtesë e *Education Podcast*) është e llojit të vet në Kosovë, si podkasti i parë me karakter edukativo-arsimor i cili trajton çështjet e arsimit në këtë formë. Synohet që me anë të EduPod të shtrihet sa më gjerë debati rreth arsimit dhe të zgjerohen hapësirat për të dëgjuar dhe përfshirë mendimet e të gjitha palëve në arsim, me fokus të veçantë tek nxënësit/et. Këto raporte analitike janë përmbledhje e diskutimeve dhe rekomandimeve të dala nga podkastet e realizuara.

Design: **envinion**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - **IDEA 2022**, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



EduPod 2

RAPORT ANALITIK

Pabarazitë në arsim

Hyrje

Podkasti i dytë i një serie podkastesh me karakter specifik edukativo-arsimor në Kosovë, quajtur **EduPod**, u realizua më 27 prill 2022 në kuadër të projektit *Zhvillimi Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development for Education Advancement – IDEA 2022*, i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës, KEC. Projekti IDEA 2022 synon përmirësimin e cilësisë së arsimit përmes identifikimit dhe trajtimit të çështjeve të arsimit në Kosovë me anë të debateve publike me bazë të gjerë. Tema e këtij Podkasti të dytë, në serinë e Podkasteve edukativo-arsimore EduPod, ishte **“Pabarazitë në arsim”**.

Kjo temë ka të bëjë me një aspekt mjaft të ndjeshëm në fushën e arsimit: pabarazitë ekzistuese mes nxënësve, posaçërisht atyre që vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, por gjithashtu edhe atyre nga grupe të tjera të cenueshme siç janë fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët nga familjet me status të ulët socio-ekonomik etj.

Hulumtimet e mëhershme të zhvilluara nga KEC kanë treguar se diskutimet publike rreth këtyre çështjeve janë instrument i dobishëm për identifikimin e problematikës shumëdimensionale të arsimit të komuniteteve në Kosovë, si dhe grupeve të tjera të cenueshme. Këtu synohet të trajtohen probleme ekzistuese si dhe sfida të reja, si pandemia e shkaktuar nga Covid-19, shumë prej të cilave i prekin direkt këto grupe dhe ndikojnë drejtpërdrejt në arsimimin e tyre.



Për të gjitha këto, si dhe çështje të tjera që ndërlidhen me tematikën në fjalë, të ftuarit në EduPod 2 ishin:

z. Orhan Butic,

Menaxher i Projekteve të Arsimit në organizatën “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve / Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” (VORAE),

znj. Luljeta Kabashi

Ushtruese e Detyrës në pozitën e Udhëheqëses së Divizionit për Arsimin Gjithëpërfshirës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Diskutimet

Luljeta Kabashi është zyrtare e Ministrisë së Arsimit që nga vitit 2004 në sektorin për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe grupe të tjera të marginalizuara, pastaj fëmijëve me talente, fëmijët e rikthyer në Kosovë, etj. Ajo ka bërë të ditur se politikat arsimore të hartuara për këto grupe të fëmijëve kanë ndryshuar përgjatë periudhave të ndryshme, gjithnjë në kërkim të adoptimit të politikave sa më të mira për ta. MASHTI ka bërë punë në vazhdimësi me qëllim që të ketë avancim dhe ngritje të cilësisë në arsimin gjithëpërfshirës, dhe punët janë realizuar varësisht nga specifikat që janë kërkuar dhe me grupet e fëmijëve që është dashur të punohet.

“Aktualisht jemi në fazën e hartim-ndryshimit të politikave të Ligjit për edukimin e hershëm dhe udhëzimeve përkatëse. Ne shumë shpejt do të hartojmë një Udhëzim Administrativ për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, i cili do të sjellë perspektiva të reja se si do të regjistrohen fëmijët duke u fokusuar fillimisht në identifikimin e tyre, në mënyrë që ata të regjistrohen në shkollë në kohën e duhur, sidomos për fëmijët që kanë vështirësi të natyrave të ndryshme në të nxënë, e të cilët shumë shpesh e tejkalojnë moshën e regjistrimit në klasë të parë”, ka thënë Kabashi.

Ajo këtu ka përmendur se fëmijët me nevoja të veçanta regjistrohen në klasën e parë në një moshë më të madhe, atëherë kur mundësitë për të ndërhyrë në formësimin e tyre janë më të vogla.

Orhan Butic, Menaxher i Projekteve të Arsimit në organizatën e shoqërisë civile VORAE, ka bërë të ditur se që nga viti 2011 ai së bashku me partnerët e kësaj organizate janë angazhuar në rritjen e numrit të nxënësve të këtyre komuniteteve në vijimin dhe avancimin e pozitës së tyre në shkollim të rregullt.

Duke folur në lidhje me sfidat në të cilat hasin komunitetet, dhe grupet e tjera të cënueshme në vijimin e arsimit, Butic ka thënë se ndihet shumë entuziast në lidhje me udhëzimin më të ri administrativ për regjistrimin në klasë të parë, të cilin është duke e përgatitur Ministria e Arsimit, me shpresën se përmes tij do të arrihet të ndryshohet situata jo e kënaqshme për sa i përket kësaj problematike për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Butic ka përmendur se që nga viti 2011, kur ai ka nisur punën me OJQ-në që drejton, njëra ndër sfidat kryesore pse gjendja është kështu siç është, pra mosgatishmëria për t'u regjistruar në shkollë, braktisja e shkollës, si dhe mungesa e vullnetit për arsimim dhe edukim, është mungesa e vetëdijesimit të prindërve dhe familjes.

“Problemi qëndron tek vetëdijesimi i prindërve, por edhe i fëmijëve. Ne e dimë se shkollimi deri në klasën e 9-të është obligativ, dhe këtu nuk vihet në diskutim nëse dikush dëshiron të shkojë në shkollë apo nuk dëshiron. Ne këtë ua kemi sqaruar prindërve, se ky nivel i shkollimit është i detyrueshëm dhe duhet ta respektojmë, por jo gjithmonë komunitetet e kuptojnë këtë”, është shprehur ai.

Ai ka theksuar se Kosova ka ndër ligjet më të mira që mund të ekzistojnë në fushën e shkollimit, por se kur flitet për zbatimin e tyre në praktikë aty çalojmë shumë. Aty ku bëhen gabimet është pikërisht regjistrimi i fëmijëve në shkollë dhe përfundimi i së paku nivelit obligativ të shkollimit, por se komunitetet nuk mbikëqyren nëse e zbatojnë ligjin në këtë aspekt.

Nuk ka arsye për lehtësime kur është fjala për komunitetet, sipas z. Butic. Nuk duhet të ketë tolerim dhe neglizhence të institucioneve për sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit edhe nga komunitetet, ka shtuar ai.

Ai ka nënvizuar se, sipas një raporti të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2010, rezultoi se as tani krahasuar me raportin e vitit 2013, nuk ka asnjë lëvizje pozitive për sa i përket komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në pjesëmarrjen në arsim. Sipas raportit të ASK-së, 85% e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vijnë në arsimin në nivelin fillor, në atë të mesëm të ulët është 65%, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë vijimi i shkollimit të tyre është vetëm 30%, ka thënë Butic, duke shtuar se këto statistika nuk kanë bërë asnjë lëvizje që nga viti 2013.

Ndërkohë që MASHTI dhe organizatat e shoqërisë civile që nga viti 2014 kanë bashkëpunuar në ngritjen e bursave për shkollim në arsimin e mesëm të lartë, për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ku çdo vit ofrohen nga 500 bursa.

“Ne kemi hasur në situata kur prindërit as nuk janë të informuar se në Kosovë ekziston ligji për shkollim të obligueshëm. Por kemi edhe situata të tilla kur prindërit e dinë këtë gjë por nuk janë të gatshëm të marrin përgjegjësi dhe të regjistrojnë fëmijën e tyre në shkollë. Këtu, natyrisht që ndikon gjendja ekonomike e vështirë e këtyre komuniteteve, gjë e cila nuk duhet të lejojë që të jetë arsye se përse fëmijët e këtyre komuniteteve nuk arsimohen”, ka thënë Butic.

Ai ka përmendur se organizata e tij së bashku me partnerët punojnë në 38 lokacione në Kosovë, dhe është dëshmuar se në vendet ku vepron ka lëvizje pozitive për sa i përket rritjes së gatishmërisë për arsimim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

“Por këto 38 lokacione nuk janë të mjaftueshme, sepse duhet vepruar kudo që ka nevojë. Është dëshmuar se, në vendet ku kemi vepruar ne, regjistrimi i fëmijëve në shkollë ka arritur në 98%, por se sa prej tyre e përfundojnë një vit shkollor, ose një nivel të arsimit, kjo është çështje tjetër”, ka thënë Butic.

Sipas tij, problemi më i madh vazhdon të mbetet braktisja sepse, siç është parë, nëse 15 fëmijë në një lokacion janë regjistruar në klasë të parë, deri në fund të nivelit të arsimit të obligueshëm kanë mbetur vetëm një ose dy nxënës. Këtu mungon ndërhyrja institucionale për parandalimin e braktisjes, ka shtuar ai.

Ndërkaq, Kabashi ka theksuar se UA do të parashikojë të gjitha hapat, që nga regjistrimi i fëmijëve me kohë, në shkollë e deri tek përfundimi i shkollimit, dhe se sigurisht do të ofrohen edhe dokumente tjera mbështetëse, siç janë udhëzuesit për shkollë.

“Mendoj se MASHTI ka punuar shumë në aspektin e parandalimit të braktisjes, dhe ka një protokoll nëpër shkolla përmes të cilit ndiqen rastet se kush janë braktisës dhe analizon arsyet e braktisjes, duke punuar pastaj për kthimin ose rikthimin e fëmijëve në shkollë”, ka theksuar Kabashi.

Ajo ka shtuar se e njëjta procedurë vlen edhe për grupet tjera të cenueshme, siç janë nxënësit me aftësi të kufizuara, të cilët regjistrohen në klasë të parë, por në shumicën e rasteve nuk e përfundojnë nivelin e shkollimit për arsye se ka mungesë të resurseve brenda shkollës për të përmbushur nevojat e tyre shtesë. Ndërkohë që prindërit në të shumtën e rasteve kanë besim të ulët tek shkolla dhe mundësitë e fëmijëve për ta përfunduar shkollimin.

Mungesa e ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, të cilët e ndikojnë edhe pjesën e rehabilitimit, po e bën të vetën. Ndërkohë komuniteteve ndoshta u mungojnë edhe materialet shkollore, librat apo gjërat esenciale për shkollim.

“Për mua, veçanërisht është i rëndësishëm është besimi që duhet të ndërtohet tek prindërit por edhe tek shkolla në lidhje me mundësitë që ka fëmija për ta përfunduar një nivel të shkollimit”, ka thënë Kabashi.

Sipas saj, në sistemin e shkollimit, si për komunitetet, ashtu edhe për grupet tjera të cenueshme, ka shumë sfida të cilat janë të identifikuar, por kryesisht ka mungesë të burimeve njerëzore që janë elemente esenciale për të pasur rezultate. Kjo ka bërë që mësimdhënësit shpesh të ndihen të vetmuar sepse nuk kanë përkrahje. Komunitat më tepër merren me nivelet dhe palët që mund ta bëjnë të realizueshëm arsimimin dhe shpesh arsyetohen se mungon buxheti, prandaj ne nuk kemi mundësi të realizojmë Planin Strategjik të MASHTI-t, i cili parashih që së paku 50% e grupeve të cenueshme ta përfundojnë shkollimin. Bashkëpunimi midis Komunave dhe Ministrisë nuk është i kënaqshëm, ka thënë ajo.

Ajo ka përmendur se MASHTI ka hartuar një kornizë ligjore, e cila është më e avancuar sesa që do të duhej të ishte, meqë praktikat dhe kultura për arsimimin lënë për të dëshiruar.

“Edhe në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, edhe tek prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, ekziston një kulturë e mosbesimit se fëmijët e tyre mund të arsimohen dhe mund të përfitojnë nga arsimit”, ka thënë Kabashi.

Duke iu rikthyer diskutimit rreth parandalimit të braktisjes së shkollës, Butic shtoi se ka shumë shkolla, por edhe Komuna, që nuk i kanë fare të konsoliduara ekipet që kryejnë këtë punë, pa çka se ekziston rregullativa ligjore, e cila është shumë mirë e hartuar në letër për këtë çështje. Sipas tij, nga 10 shkolla të pilotuara, 7 prej tyre i kanë pasur të krijuara ekipet për parandalimin e braktisjes së shkollave, 3 prej tyre nuk i kanë pasur fare këto ekip. Por se edhe në shkollat që i kanë ato, nga shtatë prej tyre vetëm dy i kanë pasur funksionale këto ekipe. Nga ana tjetër, këto ekipe reagojnë vetëm pasi ndodh braktisja, pra nuk bëjnë parandalim por vetëm reaguim.

Sa i përket Udhëzimit Administrativ 12/2017 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, i miratuar para katër vitesh, Butic ka thënë se janë afro 80 qendra të tilla, të cilat i kanë ndihmuar mjaft nxënësit. Sipas tij, edhe pse këto qendra kanë nisur një rrugëtim shumë të mirë, edhe këtu ka disa telashe në funksionim, për shkak të mbështetjes financiare, pasi që ka probleme me sigurimin e fondeve dhe kuadrin që duhet të punojë aty. Qendrat mësimore shihen si institucione shpresëdhënëse edhe për përmirësimin e cilësisë në arsim. Deri tani është folur për përfshirje në arsim, por tani është koha të flitet edhe për cilësi në arsimimin e komuniteteve, ka thënë Butic.

Dita e Diversitetit dhe Gjithëpërfshirjes është përmendur si njëri ndër aktivitetet që Ministria e Arsimit synon t'i kthejë në tradicionale, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit por edhe të promovimit të politikave dhe strategjive rreth diversitetit dhe gjithëpërfshirjes. Kjo ditë do të shënohet çdo vit me 26 prill, ku sivjet MASHT ka promovuar një dokument që flet për shkollimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e mesme të larta, ka thënë Kabashi. Meqenëse, niveli i mesëm i lartë nuk është shkollim obligues, shumë shpesh shkollat nuk bëjnë përpjekje për përfshirjen e këtyre fëmijëve dhe krijimin e kushteve për arsimimin e tyre, prandaj synohet që tash ta arrijmë këtë gjë, sidomos në shkollat profesionale, ka theksuar Kabashi.

Duke u ndërlidhur në diskutim, Butic ka thënë se është kërkuar nga MASHTI, që në librat shkollorë të përfshihen edhe kapituj në lidhje me kulturat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në kuadër të diversitetit që promovohet kudo.

Vlerësim

Nga diskutimi me të ftuarit rezulton se aktualisht MASHTI është në procedurë të hartimit të një Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, i cili pritet të sjellë perspektiva të reja për sa i përket regjistrimit të fëmijëve nga grupe të cënueshme dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në klasë të parë, duke u fokusuar fillimisht në identifikimin e tyre, në mënyrë që ata të regjistrohen në shkollë në kohën e duhur, sidomos për fëmijët që kanë vështirësi të natyrave të ndryshme të cilët shumë shpesh e tejkalojnë moshën e regjistrimit në klasë të parë.

Aty u konstatua gjithashtu se, ndër sfidat kryesore pse gjendja nuk është e kënaqshme për sa i përket arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, është mosgatishmëria për t'u regjistruar në shkollë, braktisja e shkollës, mungesa e vullnetit për arsimim dhe edukim, si dhe mungesa e vetëdijesimit të prindërve dhe familjes për rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre. U përmend se për shumë vite gjendja nuk ka ndryshuar.

Që nga viti 2013 nuk ka asnjë lëvizje pozitive për sa i përket komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për pjesëmarrje në arsim,



ku **85%** e fëmijëve të këtyre komuniteteve vijojnë arsimin në nivelin fillor

në nivelin e mesëm të ulët vijimi është **65%**,

ndërsa në arsimin e mesëm të lartë vijimi i shkollimit të tyre është vetëm **30%**.

Në këtë gjendje nuk ka ndikuar as ofrimi prej 500 bursash në vit, që MASHTI ndan për fëmijët e komuniteteve që vijojnë arsimin e mesëm të lartë.

Jo e kënaqshme rezulton të jetë edhe gjendja në arsimimin e grupeve tjera të cënueshme, siç janë nxënësit me aftësi të kufizuara, të cilët regjistrohen në klasë të parë, por në shumicën e rasteve nuk e përfundojnë nivelin e shkollimit për arsye se ka mungesë të resurseve brenda shkollës për të përmbushur nevojat e tyre shtesë. U konstatua se prindërit në të shumtën e rasteve kanë besim të ulët tek shkollat dhe mundësitë e fëmijëve për ta përfunduar shkollimin.

Ndërkohë, qendrat mësimore shihen si institucione shpresëdhënëse për përmirësimin e cilësisë në arsim, por Udhëzimi Administrativ 12/2017 që shërben si bazë për funksionimin e tyre duhet të rishikohet dhe të ristrukturohet. Deri tani është folur për përfshirje në arsim, por se tani është koha të flitet edhe për cilësi në arsimimin e komuniteteve.



EduPod 2 mund të ndiqet në:



Faqja e KEC-it në Facebook:

<https://www.facebook.com/QendraperArsimeKosoves/videos/5478305605522283>



Kanali zyrtar i KEC-it në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=tQaZDvTK4jk&t=6s>



Funded by
the European Union

